



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 13134/16 Prot

Vlorë, më: 30.10 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 3

Datë 16.10.2023 Ora: 16:30

Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha; Deputete Pranvera Resuli; Kryetare e Rajonit 3- Manuela Prifti, nenkryetarët e bashkisë; Daut Zeraj-Sekretar i Këshillit Bashkiak,, Drejtori i buxhetit dhe finances-Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF,

(Nw takim morrwn pjesw mbi 61 persona, listeprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Administratorja e Rajonit 3-Manuela Prifti- Faleminderit të gjithëve që jeni prezent në takim! Falenderoj Kryetarin e Bashkisë, deputeten dhe kryetaren e këshillit bashkiak. Na bëni me dije çdo problem tuajin!

Ermal Dredha: Kryetar i Bashkisë Vlorë- Përshëndetje dhe faleminderit. Përshëndes Pranverën dhe kryetaren e këshillit dhe të gjithë qe janë present. Jeni shumë dhe shikoj që vëmendja nga ana juaj është e lartë. Kemi filluar procesin e konsultimeve per projektbuxhetin e bashkisë. Pa marr vendimin tuaj nuk bëhet i plotë nga administrata. Përvec ligjit është mirë të dalim në një emërues

të përbashkët. Me Fondin kemi marr një dakortësi për disa rrugë për asfaltin. Nga këto 3 ose 4 rrugë janë të Rajonit 3 S'po marr kohë. Do raportoje drejtori.

Pranvera Resulaj-Deputete: Qëllimi im është që dëgjesa të kishte pjesëmarrjen tuaj. Sepse duam që mos të jetë vetëm administrate, por të përfshihemi në të gjitha fazat. Kam kaluar 2 fushata në këtë rajon, zgjedhjet vendore dhe qendrore. Kemi mbledhur problematikat, sidomos rikualifikimet e lagjeve me foto dhe duam të shtohen në buxhet. Fondi ka parashikuar një fond prioritet për lagjet dhe rikualifikimet. Jetën sociale , kopshtet dhe cerdhet. Të kemi vëmendjen edhe për qendra sociale. Të lutem që premtimet e fushatave ti bëjmë prioritet. 2024 dhe afatmesëm. Kemi mbështetje dhe do vazhdojmë.

Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë: Faleminderit Pranvera



Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024

Per me shumw klikoni linkun
<https://fb.watch/nKkMXVVQw4/?mibextid=v7YzmG>

Hiqmet Haxhij-Drejtor DFKB- Vijnë me dëgjesë për hartimin e buxhetit 2024. Treguesit bazë për buxhetin afatmesëm 2024-2026. Për vitin 2024 të ardhurat totale 2.659.506 (2 miliard ...lek) Investimet 377,748 mijë.

Investimet për vitin 2024 për Rajonin 3.

- Ndërtimi i shkollës Lef Sallata e cila do bëhet pothuajse e re. Ka qënë e palnifikuar për tu ndërtuar në vitin 2023, por fondi nuk ishte I mjaftueshëm sipas preventivit të parashikuar dhe do të kaloj me buxhetin e vitit 2024.
- Rrjeti tercial i kanaleve të ujrave të zeza
- Rehabilitimi i lagjes "28 Nëntori" (shtëpia e oficerave-shkolla e muzikës)
- Rehabilitimi i Lagjes "Dëshmorët"

- Rehabilitim i pjesshëm i Kopshtit nr.10.

Banor: Po te kisha?

Claudio Mehmetaj-Drejtor i Urbanistikës: Përshëndetje. Në vijim të prezantimit lista e investimeve. Blloku i lagjes ku është shkolla "Lef Sallata". Fasadat. Fondit I është kërkuar faltimet, akset, rruga e Cipajve, rruga "Hasan Kushta", rruga "Jeronim de Rada". Asfaltimet e punës te Kisha dhe shkollës Naim Frashëri. Janë miratuar dhe do fillojnë punimet së shpejti.

Armanvera Resulaj; Ky projekt buxhet është draft. Të marrim çfarë është emergjente dhe të vendosim.

Claudio Mehmeti: Rikonstruksion i palestrës së shkollës Lef Sallata, kopshti nr.10, rikonstruksion, nevoja për shtretër, sistemi ngrohje ftohje. Të dëgjojmë ca keni ju.

Negime Pulaj-Banore: Do e filloj me problemin e ujit të pijshëm. Kemi 27 vjet në pushtet. Është me orar pa orar.

Bolierët. Kostua që prek pensionistët, 30 mijë në muaj për ujin që blejmë për të pirë dhe 15 tarifa shkojnë 45 mijë. Ti ngrenë dhe deputetët problemet.

Rruga e Varoshit është e dëmtuar, rruga që të lidh me shkollën Musa Cakërri. Kanalet dhe ujësjellësi dhe riparimet që bëhen. Rruga e Varoshit është e dëmtuar dhe bllokohet. Dërmjet Varoshit është geto me 15 familje në Baraka, që flenë në bunkier.

Ndërtimi midis rrugëve kryesore që dalin në transballkanike me cilësi shumë të dobët.

Kishim 2 tregje. Modeste por me tavolina. Para 8 vjetëve u shkatërrua dhe tregtarët shesin në rrugë.

Rajoni 3 ka sipërfaqe më të vogël por meriton të bëhet rajon pilot.

Të rregullohet gjendja brenda pallateve se janë shumë të vjetra. Janë bërë riparime vetëm në fushata.

Pastrimi, gjelbërimi të jetë i ndërthurur. Të shtohen edhe koshat e plerave.

Me kryetaren e rajonit nuk e zgjidhëm një problem që doli në lagje me një familje që u përmbyt.


Eduard Banushi: Banor në lagjen "28 Nëntori". Kemi këto probleme në lagje, rruga me gropa, kazanët me plera. Rruga nga shkolla Internacional deri në transballkanike ka një fluks dhe nuk menaxhohet pastrimi. Kabinë elektrike ngjitur me shtëpinë. Mbas internacionalit po bëhet një ndërtesë. Ka qënë kabinë elektrike duhet hequr sepse krijon lagështi. Vendosija e tabelave në rrugica dhe lagje për të orientuar adresat.

Petrit Koci-Banor. Z. kryetar suksese, keni filluar mbarë. Në pensionistët kërkojmë tavolina shahu. Kur vendosa një tavolinë shahu u mbledh policia bashkiake dhe me hodhën në gjyq. Deputetët ku janë? Pse nuk na shikojnë?

Runa-Banor L.28 Nëntori. Te ish Shtëpia e Oficerëve. Jemi 4 pallate që nuk kalojmë dot grupa. Të vendoset linja e autobusve në transballkanike ose të shtëpia e oficerëve, një stacion e.

n Hysi-L.Pavarësia: kemi 50m rrugë që nuk futet as zjarrfiksjë as ambulance. Pas Raifasen . Duhet të shtrohet dhe asfaltohet.

ore/Italiane: kam 10 muaj që kam marr një shtëpi, kishim nevojë për ambulancën dhe nuk te dot nga pengesat në rrugë. Kam ardhur sot për ta sjellë si shqetësim.



Bexhet Kodheli-Banor. Të falenderoj që na mblodhe. Jam ish oficer.. kam këto probleme:

Uji i pijshëm- si do bëhet të hiqen bolierët?

Përgjegjësat e pallateve të rregullohen dhe kontrollohen sepse bëjnë cfarë u do qejfi.

Pastërtia, të jetë jo vetëm në rrugë kryesore por edhe në lagjet e brendshme

Shoh për herë të parë shefen e rajonit, puno si deputetja Pranvera.

Kryetar ju ke hyrë në zemër vlonjatëve, tani të takon tju Ngrohësh zemrat!

Kozma Billa-Banor: ju falenderoj për ftesën. Një pjesë e problemeve u ngritën.

Adresari është një problem i madh

Rruga te lagja ime ka një disnivel dhe shkarkojnë ujrat dhe e mbytin. 60m rrugë është, të bëhet dhe të vij në nivel nga Kisha ortodokse te shkolla.

2 banesa janë pa banorë te ish cerdhja është privatizuar dhe ka sjellë probleme. Është një mur që pengon.

Banesë e abandonuar në kushte skandaloze.

Lavazhura në krye të rrugës. Bllokohen pusetat dhe dalin ujrat e zeza.

panitë e TV kabllor me lidhje në shtylla si merimangë. Kompanitë ti sistemojnë nëntokë se rrezik.

instratori i pallatit në varësi të kujt është? Të caktohet një kuotë për ashensorin dhe pastruesen. blidhet me tarifën e ujit.

kinat e furnizimit nëpër dyqane bllokojnë rrugën orar pa orar. Të rregullohen oraret dhe të het qarkullimit.

Ernal Dredha: Sipas ligjit është e pamundur. Do e shikojmë me nënkryetarët problemin e administratorëve.

Skënder Demiri: kam 20 vjet banor në lagje, hyrje dhe dalje te rruga e Cipajve dhe rruga Kosova. pa ndricim, pa tabelë, pa parkim, pa sens kalimi. Pemët nuk janë krasitur. Jemi interesuar vetë dhe për insektet që qëndrojnë në ato pemë dhe na mbushin shtëpitë. Ndricim ska në rrugë. Rruga është e shtruar përgjysëm. Rruga Cajupi s'ka funksion dhe dalje në transballkanike. Rrugica s'ka shikim për makinat dhe është rrezik për aksidentet. Policia është në dijeni. Rruga Cajupi që del te Rosmani, është në disnivel. Është prishur trotuari. Kazanët e plerave duhet të shtohen. Zona e Kombinatit është problem I madh.

Banor-Pallati 101: Ju përshëndes dhe u uroj shëndet. Në hyrje të pallatit pinë fëmijët e moshës 15-17 vjec, s'ka ndricim.

Banore: rruga mbytet në 2 drejtime nga spitali te kasha. Femijët nuk kalojnë dot e nuk dinë si të mbrohen. Kabinat elektrike janë problem dhe telat bien mbi shtëpitë. Të rregullohen kabllot. Lokalet janë pa kritere, tavolinat në rrugë e trotuare. Koshat u hoqën dhe nuk u vendosën më.

Emiljano Hajrullaj së bashku me një banore. Kjo zonja është përjashta pa strehë.

Ernal Dredha: Kemi folur bashkë e të kam sqaruar.

Skënder Canaj-Banor: Problemi i rrugëve u trajtua dhe të zgjidhet. Ujësjiellësi ka problem me shpërdorimin. Vendosja e matësve. Abuzohet. Të shikohet administrata dhe të trajtojnë sic duhet qytetarët. Drejtoria e Ujësjiellësit vendos gjoba abusive. Me shkelje flagrante.

Thoma-Banor- Urime Ernal! Pas rrugës Ali Demi, pastrimi jemi të kënaqur. Ka një problem 2 vjecar me pallatin ku jam. Është bërë një ndërtim pa leje. U prish. Filloi prapë. Njoftuam policinë dhe erdhën. Është ndërtim pa leje. Fasada të kthehet sic ishte, pa derë dhe dritare.

Banor; L.28 Nëntori. Problem me kasetat e Telekomit, Nisatelit janë fijet mbi dritare. Edhe suvaja ka rënë.

Ernal Dredha: Do e shikojmë. Do ju bëjmë një kërkesë.

Ka ndonjë sygjërim për investim?

ore: Lagja Faik Konica-Te Sheshi i Flamurit, s'ka stol për tu ulur. Ndricimi, pa llamba gjithë a Gjergj araniti, me plera, baltë, pa trotuare. Përballë me Koloseun. Të Disney kanë plasur t e zeza. Jam ankuar dhe skam marr përgjigje. Për të bërë plazhin të tyneli skishe mundësi ku gulje cadrat. Makina e betonit lante betonin në det. Bulevardi Vlorë- Skelë është i qelbur. Asnjë në nuk ujitet. Vetëm shkurre ka ngado. Semafori??!!

Ernal Dredha: Na falenderoni për lulishtet që po bëjmë dhe rregullojmë dhe ne do shtojmë oma.

Thoma Leka-Ojf. Kemi kontratë me nënkryetaren, mund të rregullohet një pjesë midis pallateve, lulishtja, pastërtia duhen përmirësuar. Më shumë investime janë bërë me fonde të qeverisë. Kam vërejtje:

Agresiviteti I biznesit- Edhe në bulevard janë karriget jashtë.

Rruga e Transballkanikes është dhuratë e qeverisë. Po prishen rrugët.

Gjelbërimi ka qënë traditë. A është e mundur të happen gropat nga ana e bashkisë ku secili nga ne të dhuroj pëmë e ti mbjellim të gjithë? Vlorë është e jona.

Kur ka probleme themi bashkia. Bashkia jemi ne, e zgjodhëm ne, le të punojmë së bashku. Nuk jemi si Korça e Gjirokastra. Kemi detyrim.

Ernal Dredha: duhet ndërgjegjësimit qytetar në masë. Për gjelbërimin ka shumë nevojë, kemi filluar të punojmë nga hyrja e qytetit dhe po punohet me sektorin e gjelbërimit të cilët kanë qënë të angazhuar me pastrimin gjatë gjithë sezonit. Nuk jepet kontribut nga qytetarët. Puna është nder! Varetat e qytetit dhe varetat e Deshmorëve është bërë shumë punë, po pastrohen dhe po angazhohemi. Do bëhen brenda mandatit. Do shikoni ndryshimin. Nëse s'ka, do iki dhe unë dhe ato që punojmë me mua.

Thanas Hysa-Banor. Jam inxhinier elektrik. Problem e TV dhe kablllove nëpër lagje. Ju duhet të formoni një grup ekspertësh që të kqyrin dhe kontrollojnë situatën dhe të denoncojnë subjektet televizive. (Pronari i shpellës së fikut vdiq nga kabllot sheshit në rrugë).

Sot isha te sahati në Vlorë. Kulla s'ka pronar. Ktheje në identitet sahatin me orë me shkronja romake.

Jam banor në lagjen Rilindja, te shkolla 24 Maj. Rruga është e mire. Përballë shkollës pallatet janë të ndërtuara në vitet 1973. Me fondet që keni të sistemohen e të vishen me "kostum" dhe pallatet.

Besnik Resuli-Banor- Takimi që u organizua te 3 Racat u fol për bolieret mbi taracë që krijojnë probleme në soletë. Jemi dakord për asfaltimin, shkollën dhe kopshtet, por zgjidhni këtë problem. Faleminderit dhe suksese!

Ernal Dredha: Faleminderit!

Konceptoi: Albana Naçi

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

